VENDIM
Nr. 173, datë 24.12.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË "BALKAN GREEN ENERGY" SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES NGA HECET "ARRAS", "FUNARES", "DUKAGJIN", "NIKOLICE", "BULQIZE", "LURE", "ORGJOST", "LEKBIBAJ", "VELCAN", "ZERQAN", "BORSH", "LESHNICE", "SHOSHAN", "UJANIK", "KERPICE", "BARMASH", "LUNIK", "HOMESH", "MUHUR", "RAJAN", "MARJAN" DHE "TRESKE 2", SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "ll", 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 5 pika 8, 6, 7 dhe 8 të "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, nenit 18 pika 1 germa "d", të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 24.12.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Balkan Green Energy" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet "Arras", "Funares", "Dukagjin", "Nikolice", "Bulqize", "Lure", "Orgjost", "Lekbibaj", "Velcan", "Zerqan", "Borsh", "Leshnice", "Shoshan", "Ujanik", "Kerpice", "Barmash", "Lunik", "Homesh", "Muhur", "Rajan", "Marjan" dhe "Treske 2", si burime të rinovueshme energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "Balkan Green Energy" sh.p.k., është konform "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat "a", "b", "c", "d"

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 germat "a", "b", "c", "d"

Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur ne mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 germat "a", "b", "c"

Përshkrimi i centralit ...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Balkan Green Energy" sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues nga hecet "Arras", "Funares", "Dukagjin", Nikolicë", "Bulqizë", "Lure", "Orgjost", "Lekbibaj", "Velcan", "Zerqan", "Borsh", "Leshnicë", "Shoshan", "Ujanik", "Kërpice", "Barmash", "Lunik", "Homesh", "Muhur", "Rajan", "Marjan" dhe "Treske 2", si burime të rinovueshme energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani